



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 372, datë 1.6.2022

P Ë R

DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.200,
DATË 25.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN
E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKITË
MIRDITË DHE KAMZË DHE ÇAKTIMIN E TYRE SI NJËSI
ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Në vendimin nr.200, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga Bashkia Kamzë, për rikonstrukcionin e objekteve arsimore, në masën 346 791 450 (treqind e dyzet e gjashtë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, i cili i transferohet Bashkisë Kamzë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Për rikonstrukcionin e shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari", Zall-Mëner, Bashkia Kamzë, fondi në masën 55 923 450 (pesëdhjetë e pesë milionë e nëntëqind e njëzet e tre mijë e katërqind e

- pesëdhjetë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022;
- b) Për rikonstruksionin e gjimnazit "Isa Boletini", fondi në masën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe 184 248 000 (njëqind e tetëdhjetë e katër milionë e dyqind e dyzet e tetë mijë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë;
- c) Për rikonstruksionin e kopshtit Zall-Mëner, fondi në masën 56 620 000 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.”.

2. Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga Bashkia Mirditë, për rikonstruksionin e objekteve arsimore, në masën 49 636 970 (dyzet e nëntë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe i transferohet Bashkisë Mirditë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

II. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Kamzë e Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi
ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 3114/I
DATË 16 - 2022

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFORMAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKIVE KAMZË DHE MIRDITË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

